

NICOLA LAGIOIA
QYTETI I TË GJALLËVE
ROMAN

BOTIMET TOENA

NICOLA LAGIOIA

QYTETI I TË GJALLËVE

roman

Përktheu nga origjinali italisht
Eris Rusi

BOTIMET TOENA
Tiranë

Autori: Nicola Lagioia (Nikola Laxhoja)

Titulli në original: La città dei vivi

Botoi në italisht: Giulio Einaudi Editore

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Anrila Spahija

Korrektore letrare: Edona Marku

Përkujdesja grafike: Elsa Hajderaj

Kopertina: Mirjana Madhi

ISBN 978-9928-376-41-1

© 2020 Giulio Einaudi editore s.p.a., Torino

© *në shqip Botimet Toena*

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

www.toena.al

Pjesa e parë

Të gostiturit

*Roma është qyteti i vetëm i jugut
që nuk ka një lagje europiane.*

Francesko Saverio Niti

*Problemet e Romës nuk duhet të lidhen
me mbipopullimin e qytetit. Kur mbi dhé jetonin
vetëm dy romakë, i pari e vrau të dytin.*

Xhulio Andreotti

Më 1 mars të 2016-s, të martën e një dite me qiellin e pastruar nga retë, dyert e *Koloseut* sapo ishin hapur për t'iu lejuar turistëve të futeshin dhe të admironin rrënojat më të famshme të botës. Mijëra njerëz ecnin në radhë, drejt biletarive. Pengoheshin në kalldrëmin e rrugës. Kishte nga ata që ngriheshin në majë të gishtave, për të matur largësinë që nga *Tempulli i Venerës*. Qyteti, atje lart, shfrynte tërbimin në trafikun që e paralizonte krejt, në autobusët publikë të prishur që në nëntë të mëngjesit. Krahët e zgjatur nga dritaret e hapura lëshonin të shara dhe vrer, që kuptoheshin qartë. Në anë të rrugës, policët bashkiakë mbushnin fletët e gjobave që askush nuk kishte ndër mend t'i paguante ndonjëherë.

- Posi... Shko e ankohu te kryetari i Bashkisë! - shitësja në kioskën e biletave numër katër shpërtheu në të qeshura tallëse, që nxitën të qeshurat e kolegëve të tjerë.

Turisti i moshuar holandez e vështroi i habitur nga përtej xhamit. Ai mbante shtrënguar në dorë dy bileta të falsifikuara, shitur pak më parë nga një mashtrues, që ishte hequr si përgjegjës i zonës arkeologjike. Kjo batutë, për ta deleguar ankesën te kryetari i Bashkisë, ishte nga ato që përsëriteshin më shpesh gjatë javëve të fundit. Fillimisht kishte dalë nga zyrat e Komunës, pastaj ishte përhapur mes taksistëve, te punonjësit në hotele, mes pastruesve të

rrugës, shitësve ambulantë të *granitave* romane, të cilëve, në mungesë të një autoriteti të dukshëm, turistët iu kërkonin ndihmë më kot, të humbur në morinë e shërbimeve gjysmake e të çrregullta në qytet.

Turisti rrudhi vetullat. Si kishte mundësi që edhe kjo përfaqësuese e vërtetë e shtetit, e llojit të atyre që mbanin uniformë zyrtare, të dukej sikur po e vinte në lojë? Pas krahëve të tij, mërmërima e turmës në radhë filloi të rritej e të bëhej më e ndjeshme.

- Kush e ka radhën tani?

Turisti holandez nuk luajti vendit.

Shitësja e biletarisë e vrojtoi një moment, duke vizatuar një buzëqeshje të ftohtë në fytyrë.

- *Next one!*

Shumë nga ata turistë kishin fjetur nëpër hotelet me çmim të lirë pranë lagjes “Monti”, në bizneset “Bed&breakfast”, të shpërndara për qark zonës së “Porta Maxhores”. Me kokën lart, si të ishin duke admiruar një engjëll, e kishin gjetur veten me hundë përtokë, të penguar pas ndonjë qeseje me plehra apo në mbajtësen e shkullur të ndonjë tabele rrugore. Sipër tyre, mermeri i bardhë borë; nëpër rrugë, minjtë e qelbur. Dhe pulëbardhat që ushqeheshin me minjtë. Ata që kishin marrë gabim informacionet, pritën më kot mbërritjen e ndonjë autobusi, pastaj u drejtuan më këmbë drejt *Koloseut*. Ajo radhë e gjatë, që ecte ngadalë, do të mund të kishte mërzhitur cilindo në pritje, por bukuria e vdekur s’kishte lënë shteg për asgjë tjetër, veç saj: qielli sipër harqeve të gurta, kolonat dy mijëvjeçare të lashta, bazilika e Masencios. Në atë shkëlqim vezullues ndihej

një lloj kërcënimi, sikur forca të padukshme të zotëronin aftësinë për të tërhequr në mbretërinë e errësirës ata që iu dilnin kundër. Por vendasve kjo jehonë kërcënimi nuk iu bënte fare përshtypje.

Shitësja e biletarisë i ofroi shërbim një turisti tjetër. Kështu veproi edhe kolegu i saj në kabinën ngjitur. Turma e grumbulluar përpara ishte marramendëse, por kishin parë edhe më keq se atë. “Jubileu i Mëshirës”¹ kishte nisur me këmbën e gabuar. “Një dështim i plotë”, shkruanin gazetat armiqësore ndaj Papës. Viti i shlyerjes së mëkateve, i pajtimit me Zotin përmes rrëfimit, i pendesës së shenjtë, nuk tërhiqte më tepër pelegrinë, nga sa vinin në Romë për të festuar vitin e dëfrimit, të anarkisë së pandëshkuar, të hedhjes së fajit mbi kurrizin e tjetrit. Turisti i moshuar holandez hoqi dorë nga radha e pritjes. U nis me hap të ngadaltë drejt sheshit “Çinkueçento” me një djalosh në krah të tij. Mbërritën në afërsi të rrugës dhe u zhdukën pas dafinave rozë.

- Ej, nga vjen kjo erë e pështirë? - shpërtheu shitësja e biletave. Sytë i kishte të ngulur në ekran dhe kontrollonte mausin e kompjuterit me një rën dorë.

¹ “Jubileu i jashtëzakonshëm i Mëshirës” u shpall nga Papa Francesku përmes dekretit papal “Misericordiae Vultus” më 13 mars 2015, në kuadër të pesëdhjetëvjetorit të përfundimit të Këshillit të dytë të Vatikanit. Ky jubileu zgjati nga data 29 nëntor 2015 deri në 20 nëntor 2016. Jubileu ishte një dritare e përkohshme e hapur nga kisha për të gjithë ata që donin të shlyenin dhe të pastroheshin nga mëkatet e kryera. (Shën. përkth.)

Një turist kinez po priste të merrte biletat e tij.

Pasi shtypi komandën e printimit, përgjegjësja e biletarisë vrojtoi dorën. Ky ishte momenti kur u rrëqeth e gjitha. Pranë tapetit të mausit ishin shfaqur dy njolla në ngjyrë të kuqe - të kuqërremë. Ajo s'arriti ta mblidhte veten, kur njollat u bënë tri. Dhe tani, mbi tavolinë, njollat ishin katër.

- O Shën Mëri!

Turisti kinez u spraps. Përgjegjësja e biletarisë kërceu e trembur më këmbë, u ndje të pushtohet nga ndjesia më e keqe që mund të përjetojë një banor i këtij qyteti: trokitja e një fatkeqësie që kursen gjithë pjesën tjetër të njerëzve. Ngriti kokën lart. Pikat vinin nga tavani. Në atë moment, gruaja bëri veprimin që do të bënte kushdo në Romë, në rastet kur gjaku rrjedh nga muret e një zyre shtetërore. Lajmëroi eprorin e saj.

Disa orë më vonë, dy nga katër biletaritë e *Kosoleut* u mbyllën.

- Gjaku i ndonjë miu të ngordhur! - tha përgjegjësi i pasurive arkeologjike.

- Ndonjë mi gjirizi? - u dëgjua dikush nga fundi i radhës. Turma u ngërdhesh.

E mërkurë, 2 mars. Përfundimi i punimeve të ristrukturimit për qark *Koloseut* u festua me thirrjen e një konference shtypi. Por një gazetar i kronikës lëshoi pyetjen rrufe se përse vallë dy nga biletaritë qëndruan mbyllur gjatë gjithë ditës së shkuar.

Përgjegjësi u detyrua të zbulonte detajet. Një mi i madh bojëhiri kishte ngecur në pjesën e poshtme të soletës së biletarisë. Atje, i lënduar nga ndonjë shtizë hekuri e trarëve mbajtës, duhej të kishte bërë përpjekje të ikte, por kjo veç sa e kishte rënduar situatën.

- Punonjësja në detyrë pa që po i pikonte gjak mbi tavolinë. Sportelet e biletarive u mbyllën sa të kryhej shfarosja e minjve.

Rreziku nga minjtë përfundoi në faqet e para të gazetave të përditshme. Kohët e fundit brejtësit dilnin vazhdimisht nga pusetat e ujërave të zeza. Minj në zonën e stacionit “Termini”. Minj në rrugën *Kavur*. Minj dy hapa larg Teatrit të Operës. Brejtësit e kapërcenin rrugën pa e çarë kokën për trafikun. Hynin brenda dyqaneve të suvenirëve dhe i tmerronin turistët.

Gazetat sollën në vëmendje që në Romë kishte mbi gjashtë milionë minj. Edhe në Nju-Jork dhe në Londër minjtë e gjirizeve nuk mungonin, por në Romë ishin kthyer në perandorë të qytetit.

- Kjo pritej të ndodhte, pas gjithë këtyre viteve keqadmirimi, - deklaroi një urbanist.

- Problemi kryesor është mënyra si menaxhohen mbeturinat, - tha një punonjës i dezinfektimit, - s' duhet harruar që minjtë janë të gostiturit e njeriut.

Në Romë menaxhimi i mbetjeve po kalonte një stinë tragjike. Mbeturinat gëlonin të shpërndara ngado. Makinat e plehrave marshonin me ritëm të ngadaltë. Qeset e mëdha të mbetjeve mësynin rrugët me shumicë. Ndihmësmjekët e spitalit “Shën Juxhini” (minjtë qarkullonin edhe brenda spitaleve) deklaruan në media që ky ishte skandali përfundimtar, shuplaka që duhej ta detyronte qytetin të haptë sytë. Kështu e mendonte shumica. Por, menjëherë pas kësaj, ata vetë kaploheshin nga dyshimi mos ishin ende në gjumë për vete. Flatra e një pulëbardhe të stërmadhe e zhyste në hije qytetin. Romakët gjallëroheshin dhe e kalonin me shaka përsëri.

- Poo... posi jo... Shko e thuaja kryetarit të Bashkisë!

Kjo batutë ishte mjaft e njohur, sepse në Romë, në atë periudhë nuk kishte kryetar Bashkie. Komuna ishte nën administrim të përkohshëm të shtetit. Një hetim gjyqësor me emërtimin “Bota e ndërmjetme” kishte kthyer përmbyës qytetin. U vunë para gjyqit nëpunës, konsulentë, noterë, drejtues të komunës, zyrtarë publikë, batakçinj, sipërmarrës,

kriminelë të zakonshëm, që s'kishin të mbaruar. Dhe gjëja më e pabesueshme: në Romë ishin në pushtet dy Papë.

Në periudha të tilla hutimi, banorët e Romës, besnikë ndaj një tradite antike, ndodhte që të vrojtonin me ngulm qiellin, në pritje të ndonjë shenje nga lart. Por edhe kjo punë - të kërkoje mes resh një kod sekret - në vitin 2016 ngjante të shëmbëllente me një ndërhyrje mashtruese.

Të premte, më datën 4 mars, u krye vrasja.

Ditën tjetër, Roma u përmyt nga shiu.

Të dielën, më 6 mars, në mbyllje të një jave të lodhshme në punë, Mario Anxheluçi ishte zhytur në kolltuk dhe po shihte televizor. Ishte diku rreth pesëdhjetë e katër vjeç, me trup të dobët dhe flokët e rënë në tëmtha. Punonte në një radio lokale. Përvoja e kishte bërë të ndjeshëm në dëgjimin e tingujve. Kur gjendej në studion e punës, përpara tastierës, nuk kishte nevojë të ndiqte arsyetimin e folësit: i ndiente “titrat” e diskutimit radiofonik, e afronte gishtin mbi tastin e zi dhe shkëputja nga transmetimi fillonte as gjysmë sekonde pasi zëri kishte pushuar së foluri.

Mario ndryshoi kanalin. Shfryu me vete. Kërkoi një vend më të rehatshëm mes jastëkëve. Qetësinë ia kishte prishur diçka që dëgjoji pak më parë. Nuk i kishte kushtuar vëmendjen e duhur fjalëve, por e dinte që lidheshin me diçka të rëndësishme. Lajmin e rigjeti në kanalin *Rai 1*. Spikerja e lajmeve po thoshte që një njëzetvjeçar ishte vrarë në mënyrë mizore në një apartament në periferi të Romës.

Telekamera shfaqti në ekran një pallat në ngjyrë protokolli që ngrihej mes pemëve në fund dimri. Mario Anxheluçi fërkoi sytë. Vrasja kishte ndodhur në Romë dhe ai ishte nga Roma. Kishte ndodhur në zonën mes “Kollatinos” dhe “Kolli Aniene”, që ishte zona ku banonte ai vetë. Por televizori po tregonte prej së jashtmi të njëjtën dritare që ai vetë mund ta hapte nga brenda, po të ngrihej e të shkonte drejt saj. Anxheluçi u pushtua nga një prej ndjesive më të

çuditshme në jetën e tij. Iu duk sikur ishte nën vrotimin e perëndisë. Dhe çfarë ndodh, zakonisht, kur Zoti e shqyen syrin mbi ty personalisht?

“Rruga Ixhino Xhordani, nr. 2.”

Si dëshmi që nuk kishte luajtur mendsh, spikerja e lajmeve sapo germëzoi qartë adresën e shtëpisë së tij. Mario Anxheluçi kërceu më këmbë. Doli me hap të shpejtë në korridor. Zemra po i rrihte fort. I biri ishte njëzet e një vjeç, e kishte parë për herë të fundit mbrëmjen e shkuar, ai dhe e shoqja e përshëndetën kur djali doli nga shtëpia, por nuk e kishin ndier të kthehej atë natë. Mbrëmja e së shtunës. Ajo ditë e javës kur të rinjtë hyjnë në telashe.

Mario Anxheluçi mbërriti në fund të korridorit. E hapi kanat derën. U trullos nga një duhmë e pakëndshme ajri i ndenjtur. Më pas, drita ndriçoi dhomën brenda. Peshqirë, revista me vizatime, çorape të mbledhura shuk, një rrotullame me letër higjienike. Mario Anxheluçi vrojtoi kuvertat e kthyera përmbys mbi krevatin, ku kushedi çfarë çudirash kishin ndodhur, e mbi krevat, një gorillë një metër e nëntëdhjetë i gjatë që gërhiste në mënyrë të pahijshme.

Një javë më vonë, kur në krejt Italinë flitej vetëm për atë vrasje, Mario Anxheluçi komentonte ngjarjen me kolegët e tij:

- Miq, ishte më keq se një sulm i papritur ankthi. E sajova me vete një film të tmerrshëm, që s’ishte as në qiell, as në tokë.

Kolegët e radios e pyetën sesi mund t’i kishte shkuar në mendje, që i biri mund të ngatërrohej në një histori të tillë.

- Ç’të them, as vetë nuk e shpjegoj dot.

Gazetat shkruanin që vrasja ishte kryer në apartamentin e katit të dhjetë.

- I njihje të zotët e atij apartamenti? - e pyeti njëri prej kolegëve Anxheluçin.

- Sa për një “Mirëmëngjesi” dhe “Mirëmbërëma”, - u përgjigj ai.

- Por, kur të kapi ankthi, të shkoi mendja që yt bir ishte djaloshi i vrasës, apo vrasësi?

- Për sa më takon, mund të ishte si njëri po ashtu dhe tjetri, - ia ktheu ai. - Në këtë qytet mund të ndodhë gjithçka!

Dhe në atë pikë, Anxheluçi, të cilit fytyra e zgavruar dhe buzët e shtrënguara i jepnin përherë një shprehje pak të ashpër, u çel në një buzëqeshje të mrekullueshme. Lehtësim. Lehtësim që u kursye këtë herë, që u shpërfill, sepse askush nuk e di paraprakisht mbi kë do të zgurdullohet Syri i Perëndisë dhe megjithëse tragjedi të tilla i bien më qafë një të vetmi mes njëqindmijëve, ai i gjori i pafat, gjithsesi, duhet të ekzistojë: mbi shpinën e tij thyhet - me qëllim që të mbetet i paprekur te të tjerët - iluzioni që këto gjëra të frikshme neve s’kanë për të na ndodhur ndonjëherë.

Në orën 13:30 të ditës së diel, në datën 6 mars, Mario Anxheluçi e dinte tashmë që familja e tij ishte jashtë rrezikut. Disa orë më vonë, nga ana tjetër e qytetit, avokati Andrea Florita mori një telefonatë. Florita ishte dyzet e pesë vjeç. Me fizik elegant, vështrim të çelët e inteligjent, e si shumë kolegë të tij kishte zënë një studio ligjore në Prati. Në qytet, pushteti dhe mrekullitë ishin ndarë në mënyrë të barabartë në të dyja brigjet e lumit Tevere. Në anën e djathtë gjendeshin rrënojat e Fori Imperiali, Kuirinale - selia e presidentit dhe

godina e qeverisë kombëtare. Në krahun tjetër gjykatat, *Rai* - radiotelevizioni italian, Kapela Sistina - Vatikani. Atë të diel Florika e kishte kaluar ditën me të birin. “Djalin e kam të vogël. Kur jam me të, i shmangem ndezjes së televizorit. Kur u përgjigja në telefon, nuk e kisha idenë se ç’kishte ndodhur.”

Avokati dëgjoi nga ana tjetër zërin e një burri të pjekur.

- Mirëmbërëma avokat Florita, më quajnë Xhuzepe Varani. Më kanë vrarë djalin.

Vetëm në mbrëmje vonë Florita e kuptoi që ishte bërë avokat i palës civile në një nga gjyqet më të bujshme të viteve të fundit. Pasi bisedoi me Xhuzepe Varanin, kur po kthehej në shtëpi takoi rrugës një të njohur. Ky i fundit e pyeti se ç’mendim kishte rreth vrasjes, para se avokati të mundej t’i tregonte se cili ishte klienti i ri i tij. Të gjithë kërkonin opinione rreth vrasjes. Mbi të gjitha, donin të shfaqnin mendimin e tyre. Brenda pak orësh, në Romë, ky krim u kthye në temën kryesore të bisedave. Për këtë ngjarje flisnin taksistët në stacionin “Termini”, baristët në sheshin “Bolonja”, grupet e të rinjve që bënin jetë nate në “Monti” dhe në “Testacio”. Për të mos përmendur pastaj atë çka ndodhte brenda shtëpive. Baballarë që ziheshin me djemtë. Bashkëshorte që qortonin burrat mbi pasojat e një edukimi me liri të tepruar, ose e kundërta, shumë të ashpër.

“E lexove?” “E dëgjove?” “E pe se ç’ndodhi?”

“Tmerr në periferinë e Romës. Një i ri njëzetetrevjeçar është gjetur i vrarë brenda një apartamenti në “Kollatino”, pasi ishte torturuar me orë të tëra. Krimi, në dukje, është bërë pa motive të qarta.”

Nga gazeta “Republika”, e datës 6 mars 2016.

Të shtunën e datës 5 mars Manuel Fofu u vra në shtëpi, pas orës shtatë të mëngjesit.

Kishte lënë të takohej me nënën e tij, me të vëllain dhe me gjyshërit nga e ëma. Dita parashikohej të ishte e zymtë. I kishte vdekur dajë Rudolfi. Në fillim duhej të shkonin në morgun e spitalit “Binjakët”, pastaj do të drejtoheshin për në Banjoli del Trinjo, fshat i vogël i rajonit të Molizes nga e kishte origjinën daja, ku parashikohej të kryhej ceremonia e varrimit.

Rudolfi ishte i vëllai i Danjelës, nënës së Manuelit dhe Robertit. Kishte ndërruar jetë nga kanceri në moshën pesëdhjetetetëvjeçare. Natën mes të mërkurës dhe të enjtes, Danjela kishte qëndruar në kryet e tij, në spital. Roberti shkoi ta merrte në orën tre e gjysmë të mëngjesit dhe e shoqëroi në shtëpi. Sapo u fut në apartament, gruaja kishte zënë një karrige në kuzhinë dhe qëndroi atje, në heshtje, e rrethuar nga vetmia që ai pallat e ndillte vetiu. Pastaj kishte rënë të flinte. Disa orë më vonë, telefoni nuk pushonte së rëni. Ishte përsëri i biri, Roberti. - Gjendja e dajë Rudolfit, - i tha, - u përkeqësua me shpejtësi.

Danjela më pas kërkoi me ngut këpucët, veshi një pallto dhe doli përsëri nga shtëpia. Mori rrugën më këmbë drejt prindërve të moshuar që banonin në pallatin përballë. Duheshin përgatitur për më të keqen. Në mbrëmjen e po asaj dite do ta konstatonte edhe vetë, personalisht, se - sado

që ta përgatitësh për lajmin e hidhur një nënë - nuk ka kufij ndaj lajmeve të këqija që kanë të bëjnë me fëmijët e tu.

Manueli u gjend poshtë pallatit. Kishte një trup të bëshëm, i gjatë, me flokët e rënë në tëmtha, me faqet e mbushura me një grusht qimesh të pavendosura: shumë të dendura për të lënë një mjekër të vogël majuce dhe të pamjaftueshme për një mjekër të plotë në gjithë fytyrën. Me sy, tregonte më shumë se njëzetënëntë vitet që do të mbushte në fund të muajit, e megjithëse atë mëngjes kishte një pamje të dërrmuar - me fytyrën e ënjtur dhe sytë me rrathë të zinj - gjëja e parë që i ra në sy të ëmës ishin pantallonat e tij. Një palë xhinse të zbardhura dhe të grisura. S'mund të quhej aspak veshje e përshtatshme për një ceremoni varrimi. Por arsyet, të cilat mamatë i konsiderojnë të papërshtatshme zgjedhjet e fëmijëve, janë përherë disi të çuditshme.

- I thashë të ndërronte rrobat, sepse në Banjoli klima është e ftohtë, - iu tha karabinierëve ajo.

Manueli kishte pohuar me kokë, u zhduk pas portës hyrëse të pallatit dhe u kthye disa minuta më vonë, me pantallonat e ndërruara. Prapë xhinse, por nuk ishin të grisura.

- Nuk e di nëse i ndërroi në apartamentin e tij apo në shtëpinë time. Atje i mbaj rrobat e lara të tij.

Apartamenti i Danjelës ishte në katin e nëntë. Manueli banonte në të dhjetin. Zonja Paloto i kishte çelësat e banesës së të birit, ngjitej vazhdimisht dhe e pastronte. Kjo ndodhte shpesh kur Manuelit i duhej shtëpia për "të kaluar kohë me ndonjë shoqe". Natyrisht, Manueli mikpriste edhe shokët. E ëma gjendej përherë atje, e gatshme ta ndihmonte sadopak.

I risistemonte dhomat. Pastronte dyshe-menë. Këto ishin punë që Manueli s'i honepste fare. Ai nuk kishte as makinë larëse dhe teshat ia lante përherë e ëma.

Danjla kontrolloi sa ishte ora. Pas pak do të kalonte t'i merrte Roberti, do të hipnin në makinë dhe do të linin pas krahëve pemët, lulishtet, kishën dhe pallatin hijerëndë portokalli brenda të cilit, pa dijeninë e asnjërit, me përjashtim të Manuelit, ruhej ajo që do t'i ndryshonte përgjithmonë jetët e tyre.

Kohë më parë, brenda apartamentit në katin e nëntë, familja Fofu jetonte e plotë, mamaja, babai dhe dy fëmijët. Kur Roberti mbushi tetëmbëdhjetë vjeç, fitoi privilegjin të përdorte apartamentin e katit të sipërm. Disa vjet më vonë, martesë e prindërve hyri në krizë. Erdhi ndarja mes tyre. Babai, Valteri, u largua nga shtëpia. Më pas iku edhe Roberti që tani ishte i martuar, me dy fëmijë. Manueli ishte zhvendosur lart.

Valteri ishte pronar i disa restoranteve në "Kollatino". Veç tyre, zotëronte edhe një agjenci për kurse automobilizmi, mjaft e njohur brenda zonës, dhe Roberti punonte bashkë me të. Nuk ishte e lehtë të kujdeseshe për gjithçka. Nëse nuk ke lindur i pasur, të jesh sipërmarrës në Itali do të thotë të jetosh në një gjendje të vazhdueshme shqetësimi. Nuk mbyll sy natën. Mjafton një lëvizje e gabuar për të humbur gjithçka. Por Valter Fofu nuk kishte humbur gjithçka. Ai dhe Roberti punonin shumë, nuk trembeshin nga vështirësitë dhe kur mundeshin, nuk hiqnin dorë nga ndonjë luks i vogël. Mbanin rroba të shtrenjta. Lëviznin me makina të bukura.

Në orën 07:30 Robert Fofò mbërriti në rrugën *Ixhino Xhordani*. Parkoi makinën. Danjela dhe gjyshë me gjyshen u ulën prapa, Manueli zuri vend në krah të të vëllait. Makina u vu në lëvizje. Tridhjetë minuta më vonë kapërcyen urën *Tor di Kuinto*, poshtë së cilës rrymat e Teveres rrjedhin të turbullta e të shtruara. Roberti ishte i përqendruar në timon. Manueli mezi po ia dilte t'i mbante sytë hapur. Si janë vëllezërit... Ka gjithmonë diçka si të sikletshme, kur i sheh pranë njëri-tjetrit. Me përjashtim të rasteve kur ndryshimi i madh në moshë i justifikon të gjitha dallimet e tjera, ka rrezik të dallosh përherë, në gjakun e të njëjtit gjak, ndryshimin mes atij që e fiton dhe atij që e humbet betejën e jetës.

Roberti ishte katër vjet më i madh sesa Manueli, ishte diplomuar në Universitetin "Luis", duke mbrojtur temën e diplomës në Shkencat e Sigurimeve. Punonte. Kishte krijuar familjen e tij. Manueli ishte përsëritës në Fakultetin Juridik, kishte një jetë të çrregullt sentimentale, nuk kuptohej dot lehtë si i kalonte ditët. Roberti po i shpinte të gjithë që t'i jepnin lamtumirën e fundit një të afërmi të vdekur, por edhe një detyrë kaq banale sa kjo - të shtrëngoje timonin e makinës - nuk mund t'i pranonte dot vëllezërit në role të këmbëryera. Manuelit i kishin hequr patentën për drejtim në gjendje të dehur. Përveç alkoolit tej normave të lejuara, në gjak i kishin gjetur edhe gjurmë *Xanax-i* dhe *Rivotril-i*. E kush nuk i përdor sot benzodiazepinat?

Pjesa më problematike lidhej me punën.

"Me çfarë merresh ti në jetë?"

Roma është një qytet që pranon që të jesh i vagullt për ndonjë çështje të caktuar. Megjithatë, kur tejkalohej kufiri,

dashamirësia kthehej në tallje. Për këtë arsye, Manueli, atëherë, i ngacmuar rreth jetës së tij profesionale, mund të ndihej i shtyrë që të fliste për vetveten në mënyrë aventuriere.

“Unë kam disa pika restaurantesh që i drejtoj bashkë me familjen. Jo vetëm kaq, por po merrem edhe me disa projekte digjitale. Jam në zhvillim e sipër të një aplikacioni start-up.”

Kur e njëjta pyetje i drejtohej të vëllait, përgjigjja ishte: “Manueli vjen në restorant si klient. Është i dhënë pas marketingut, lexon shumë, herë pas here mundohet të na japë ndonjë ide, por faktikisht nuk kryen asnjë lloj pune”.

Valteri fliste për djalin e vogël, duke theksuar tiparet e karakterit të tij: “Është një djalosh korrekt, i sjellshëm, shumë i dashur, i tërhequr. Në shkollë nuk është zënë kurrë me njeri”. Po ashtu, sipas të atit, Manueli ishte “shumë inteligjent”, bënte një jetë “të rregullt”, kishte etje për dije (“është në gjendje të blejë edhe dy libra njëherësh, për t’i lexuar brenda natës”), por asnjëherë nuk kishte shfaqur ndonjë interesim të madh ndaj garave automobilistike që mund t’i siguronin një të ardhme (“jam munduar ta përfshij, siç bëra me Robertin. Ishte e kotë”). Djaloshi ndiqte me pasion kurse të marketingut dhe të informatikës (“Paratë për të ndjekur këto kurse ia jap unë”), dhe gjatë muajve të fundit, faktikisht, kishte punuar me vull për një aplikacion *start-up*. Bëhej fjalë për një projekt që lidhej me KOKI¹-n,

¹ Në italisht Coni - Komiteti olimpik kombëtar italian. (Shën. përkth.)

falë të cilit - thoshte gjithmonë Valteri - “mund ta merrte kthesën e duhur në jetë”. Nuk shkoi si duhej.

Kur baballarët flasin kështu për djemtë e tyre, nuk është asnjëherë e qartë nëse synojnë që t’i mburrin, t’i ulin apo t’i lënë në mëshirë të atij ushtrimi të pandëshkueshëm turpërimi, që është lavdërimi me tepri.

Por deklarata më e çuditshme për Emanuelin vinte nga e ëma: “Manueli nuk më tregon nëse shkon në restorant që të punojë apo jo. Nuk e di me saktësi as se çfarë lidhje ka me të atin”.

Pasi e kapërcyen rrugën *Pineta Saketi* u shfaq trajta gjigante e spitalit “Binjakët”. Roberti parkoi makinën. Zbritën që të pestë dhe u futën brenda ndërtesës spitalore.

Manueli tani ecte duke i tërhequr zvarrë këmbët, e ndiente mbi vete vështrimin e të vëllait. Para dy ditësh, në një orar që për Robertin mund të ishte shtatë e mëngjesit, ndërsa për Manuelin çfarëdolloj ore në një vijë të marrosur kronologjike, Robertit i erdhi një mesazh që ishte pak ta quaje absurd. Si efekt joshës, propozonte një transeksuale dhe kokainë.

- Si je Robert, do na bashkohesh? Kam takuar një trans. Kemi dhe ca “*bamba*” me vete.

Përveç përmbajtjes, mesazhi ishte i çuditshëm për zgjedhjen e fjalëve. Roberti nuk e përjashtonte faktin që Manueli pinte ndonjëherë kokainë, i dukej e pamundur që frekuentonte transeksualë, por ishte i sigurt që nuk do ta kishte përdorur kurrë termin “*bamba*” për të nënkuptuar kokainën. E kishte shkruar vërtet ai atë mesazh? Ndoshta Manueli e kishte kaluar natën me ndonjë rrugaç dhe kishin

vendosur së bashku të argëtoheshin në kurriz të njerëzve që të nesërmen duhej të zgjoheshin herët për të shkuar në punë. Po talleshin me të? Roberti i nervozuar i telefonoi Manuelit, duke iu hakërruar për disa sekonda, pastaj e dërgoi në dreq pa i dhënë mundësinë të shpjegohej.

Edhe zonja Danjela tregoi një episod disi të çuditshëm që kishte ndodhur një ditë më parë. Manueli e kishte marrë në telefon rreth orës 21:30.

- Më dëgjo, ma, për çerek ore do të kaloj të marr çelësat e makinës bashkë me një shok.

Zonjës Danjela nuk i kishte ardhur hiç mirë nga fakti që Manueli kishte dashur ta bënte bashkëpunëtore në një shkëlje të ligjit. Pastaj, kush ishte ky shoku?

- Unë s'të jap gjë prej gjëje, - i ishte përgjigjur ajo. Kishte ndërruar jetë dajë Rudolfi, duhej të merreshin me të tjera gjëra. - Sidoqoftë, - iu tregoi Danjela karabinierëve, - kërkesa e tim biri m'u duk aq absurde, sa gjithçka, në përfundim, u shkëmbye me batuta mes nesh, si të ishte një shaka krejt e pafajshme.

Danjela ishte treguar e prerë në qëndrimin e saj. Manueli nuk kishte ngulur këmbë.

Manueli u fut në sallën e morgut, i mbikëqyrur nga vështrimi i rreptë i Robertit, e nga vështrimi i të ëmës, që e falte. Sidoqoftë, falja është një mënyrë gjykimi. Shpatullat e kërrusura dëshmojnë betejën që na duhet ta përballojmë në faza të caktuara të jetës, që të mos lejojmë që dinjiteti ynë - ose ajo çka e konsiderojmë të tillë - të përmbysset nga imazhi i remë që kanë të tjerët rreth nesh.

Manueli u shty mes të afërmve dhe i shkoi pranë arkivolit të dajës. U ndal të vrojtonte kufomën dhe i premtoi vetes të merrte vendim brenda natës. Të dish! Të dish kur të tjerët nuk dinin gjë. Kjo ishte një ndjesi e re. Manueli e dinte që para se e ëma t'i këshillonte të vishte pantallona të tjera, e dinte edhe kur ishte i ulur krah të vëllait në makinë, e dinte dhe tani, në dhomën mortore. Dinte diçka që të tjerët as mund ta imagjinonin dot. I mësuar që të pësonte vendimet e të tjerëve, tani ishte ai që mund të vendoste. Një grusht fjalësh. Thjesht t'i shqiptonte dhe do të kthente përmbys jetën e të gjithëve. Por, më pas, sapo dolën nga spitali, Manueli e gjeti veten që s'kishte nxjerrë asnjë fjalë. Ishte i lodhur, i turbullt, e ndoqi Robertin drejt makinës. Pritën të vinin edhe e ëma me gjyshërit dhe më pas makina u nis.

Funerali parashikohej të bëhej në fillim të pasdites. Makina u fut në rrugën *Flaminia*. Pas nja njëqind kilometrash do të bënë një ndalesë. E kishin lënë të takoheshin me Valterin në “San Vitore”. Mes atij dhe Danjelës marrëdhënia ishte e tensionuar. Beteja ligjore mes tyre ishte në zhvillim e sipër. Por prapëseprapë, Valteri kishte vendosur të merrte pjesë në varrimin e ish-kunatit.

Në horizont po nxinin re të mëdha të ngarkuara me shi. E lanë pas “Torre Spakatan”, “Çineçitanë”, e në anë të rrugës spërdridheshin kullotat e fshatit romak. Manuelin e kaploi gjumi.

- Lërja vendin gjyshit, kështu kemi më tepër hapësirë.

U zgjua një orë më vonë nga i vëllai. I ndiente cicërimat e zogjve. Kishin ndaluar në një stacion shërbimi. Përpara tyre, një lokal i vogël. Disa minuta më vonë mbërriti ai. E dalluan

makinë kur bëri një gjysmë rrethi para se të ndalonte, e më pas burri zbriti prej saj. Valter Fofos i mjaftonte të shfaqej, që të tërhiqte mbi vete vëmendjen e të afërmeve. Manueli i la vendin gjyshit, doli nga makina e Robertit dhe u drejtua tek ajo e të atit. Sapo zuri vend, djaloshi e ndjeu shkarkesën elektrike. Ka nga ata etër e bij ku mund të krijohen vorbulla stuhie edhe kur nuk ka ndodhur asgjë, le më pastaj kur njëri prej të dyve beson që tjetri nuk e ka respektuar si duhet. Në këtë rast ishte Valteri ai që ndihej i fyer. Manueli kujtonte se e dinte arsyen. Valteri nuk tha asnjë fjalë dhe e ndezi makinën.

Disa minuta më vonë makina nxitonte mbi asfalt. Herë pas here Valteri e vrojtonte të birin, më pas flokët e tij në pasqyrën e pasme. Ishte një gjashtëdhjetëvjeçar i pashëm, s'kishe ç'thoshe. Me flokë të bardhë, buzë mishtore, një hundë që në antikitet mund të kishte qenë fare mirë hundë e ndonjë konsulli. Atë ditë kishte veshur një xhaketë të zezë me këmishë të bardhë, kravatë me vija dhe pantallona të errëta. Së jashtmi, kaq i mbajtur dhe elegant, zor se mund të merrej me mend sa i stresuar ishte. Puna nuk i jepte çlodhje, por as familja nuk mbetej pas. Më në fund e hapi gojën:

- Do të më thuash çfarë ndodhi?

Valteri e përshkruante të birin te të tjerët si një djalë të përmbajtur e të paaftë për të gënjer. Por kur e kishte para syve, ato cilësi që në sytë e të huajve duhej të kishin vlerë të madhe morale, merrnin një kuptim tjetër. Sinqeriteti mund të ishte një tregues dobësie, sjellja e përmbajtur - paaftësi për t'u shprehur.

- Mund ta di nga humbe?

E kishte kërkuar gjatë gjithë ditës së djeshme. I kishte telefonuar pa fund, pa marrë asnjë grimë përgjigjeje. Si përherë, i ishte dashur ta ndiqte nga pas të birin, për t'i bërë një nder: duhej t'i paguante këstin për një nga kurset e shumta që ndiqte Manueli, por i nevojiteshin të dhënat për transfertën bankare.

Manueli rrinte pa folur në sediljen e pasagjerit. Sytë i kishte të fryrë. Kjo nuk i kishte shpëtuar të atit, sapo e kishte parë në stacionin e shërbimit e kishte kuptuar që diç nuk shkonte. I biri po sillej çuditshëm. Njeriu që sipas Manuelit ishte i aftë ta keqkuptonte më shumë se kushdo tjetër në botë, ishte edhe i vetmi që kishte nuhatur që i biri, atë ditë, mund t'iu hapte më shumë telashe sesa vdekja e dajës.

- Hë pra? Të bëra një lumë telefonatash. Përse nuk përgjigjeshe?

Manueli i pat premtuar vetes të merrte një vendim pa zbritur nata, por kur i ati i qepej me marrjen në pyetje, ishte i aftë t'ia shkulte fjalët nga goja.

- Hë pra, nga ishe futur? Kishe pirë? U dehe? Manuel!

- Babi, isha nën efektin e kokainës.

Lanë pas një baxho, e më tej edhe një fabrikë tendash për t'u mbrojtur nga dielli. Një grup i vogël plepash ngrihej vetmitar nëpër fushë, i ledhatuar nga dielli i pasdites. Valteri doli nga gjendja e topitjes ku e kishin degdisur fjalët e të birit.

- Si nën efektin e kokainës? - zëri i bulonte nga inati. - Si arrite të biesh kaq poshtë?

Shprehjet e gatshme ka raste kur dalin të dobishme.

- Babi, në fakt kam rënë akoma më poshtë.

Valteri tani e humbi fare toruan. Në buzë iu formua një pyetje vërtet mjaft naive:

- E çfarë mund të ketë më të keqe sesa kokaina?

- Kemi vrarë një njeri.

Makina vazhdoi rrugën në autostradë. Kapërcyen një pikë benzinate, një mbikalim, më pas u shfaq një tabelë që i ftonte sipërmarrësit e zonës të blinin hapësira reklamuese.

- Ç' do të thotë "kemi vrarë"?

Valteri u ndje i trullosur, i shtangur, nuk e besonte, iu përndezi diçka në stomak, por goditja që mori nuk e pengoi të kërkonte rrugëdalje instinktivisht. Përdorimi i numrit shumë. Prania e një njeriu tjetër mund të ulte, në mos të përjashtonte, përgjegjësinë e djalit të tij. Valteri ndjeu zemrën t'i përshpejtonte rrahjet. Teksa po përpiquej ta gjente ku të kapej në atë rrëmujë, në atë labirint, në absurditetin ku po e kuptonte, çast pas çasti, që e kishin flakur, e zuri veten që po orientohej drejt vrasjes nga aksidenti rrugor. Manueli duhej të kishte pirë. E kishte bërë edhe herë tjetër. Megjithëse ia kishin hequr patentën, kishte vozitur makinën gjysmë i dehur. Ja se çfarë kishte ndodhur. Manueli kishte bërë një gomarllëk. Gjithmonë, nëse kishte qenë ai që i kishte dhënë makinës.

- Babi, nuk ndodhi asnjë aksident rrugor.

- Po atëherë, si u vra ky person?

- Me thika, besoj. Dhe me goditje çekiçi.

Valteri ia nguli mirë sytë rrugës, të sigurohej që gjendej akoma atje, i kthjellët, mbi të njëjtin planet ku ishte zgjuar në mëngjes. E dëgjoi zërin e vetes që pyeti Manuelin për emrin e bashkëpunëtorit.

- Një që quhet Marko. Mund ta kem takuar veç nja dy herë gjithë jetën.

- Dhe në ç'kohë mund të kishte ndodhur ky fakt?

- Nuk më kujtohet, - u përgjigj Manueli, - para dy, tri, pesë ditësh.

Dy, tri, pesë ditë më parë?

Si mund të mos e dinte? Ekzistonte ende mundësia që krejt kjo të ishte një shaka idiote? Në fijet e pafundme të keqkuptimeve, që lidhin etërit më bijtë, e që shtyjnë një pjesë të bijve të mendojnë që janë fyer, e në mos po, janë dëmtuar njëherë e përgjithmonë nga sjelljet që baballarët vënë në zbatim me qëllimin e thjeshtë për t'i bërë burra, a mund të ekzistonte edhe ajo e një hakmarrjeje absurde? A bëhej fjalë për një histori që Manueli e kishte sajuar kokë e këmbë, për ta ndëshkuar për faje që madje edhe psikologu ku e pat dërguar njëherë Valteri, do ta kishte pasur të vështirë t'ia hidhte atij përsipër?

Valteri e pyeti të birin për emrin e viktimës. Manueli u përgjigj:

- Nuk e di!

Sytë iu mjegulluan nga lotët.

Atëherë Valteri pyeti se ku gjendej personi që i biri thoshte se e kishte vrarë.

Këtë fakt Manueli e dinte.

- Në shtëpi, - i tha. Trupi gjendej në apartamentin e tij, në rrugën *Ixhino Xhordani*.